



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Për : “Instituti i Konsulencës në Ndërtim” ‘IKN’**  
me adresë : Rruga “Eduard Mano”, Pallati 20, Kati 0, Farkë.

**TIRANË**

Procedura e prokurimit : **Kërkesë për Propozim – Shërbim .**

Numri i referencës së procedurës : REF- 82466-12-17-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës , objekti : “ **Mbikqyrje punimesh për Ndërtimin e ujësjellësit për fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Sheqëz, Vodëz, Krekëz dhe Koritëz Njësia Administrative Lumas gjithashtu dhe ndërtimi i pjesshëm në fshatin Tapi, Njësia Administrative Perondi, Bashkia Kuçovë** ”, me fond limit : **3 992 821.6** ( tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzetë e një pikë gjashtë ) **lekë pa tvsh .**

Afati për ekzekutimin e kontratës : Do të jetë 18 ( tetëmbëdhjetë ) muaj nga data e lidhjes së kontratës .

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se në procedurë kanë ofertuar **3** ( tre ) operator ekonomik dhe konkretisht si më poshtë :

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “**A & E Engineering**” shpk me Nr NIPT-i K72113010E dhe “**M.A.K Studio**” shpk me Nr NIPT-i L01422017O me ofertë ekonomike : **3 459 535.438** ( tre milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë pikë katërqind e tridhjetë e tetë ) lekë pa tvsh .
2. “**Gjeokonsult**” shpk me Nr NIPT-i K91810005U, me ofertë ekonomike : **3 474 804** (tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e katër ) lekë pa tvsh .

3. **“Instituti i Konsulencës në Ndërtim ” ‘IKN’** shpk me Nr NIPT-i K71828007J me ofertë ekonomike : **3 770 993** ( tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre ) lekë pa tvsh .

\* \* \*

**Janë skualifikuar operatorët ekonomik ofertues si më poshtë :**

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“A & E Engineering”** shpk me Nr NIPT-i K72113010E dhe **“M.A.K Studio”** shpk me Nr NIPT-i L01422017O rezulton me mangësi në dokumentacion dhe konkretisht si më poshtë :

- Nuk kanë paraqitur në listën e stafit kryesor si drejtues teknik mbikqyrësin për mjedisin, si dhe nuk ka paraqitur një inxhinier me licensë në mbikqyrje që të ketë certifikatën si përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis.
- Oferta e këtij operatori është nën vlerën minimale të VKM-së 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”. Vlera minimale e lejuar sipas VKM-së së mësipërme është 3 770 993 lekë pa tvsh .

2. **“Gjeokonsult”** shpk me Nr NIPT-i K91810005U, skualifikohet me arsyen se :

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka ndjekur hapat e parashikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 në përlllogaritjen e vlerës minimale të lejuar. Bazuar mbi vlerën e projektit dhe fondin limit të Mbikqyrjes së punimeve të miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetieve, Drejtoria e Planifikimit të Investimeve, Sektori i Planifikimit të Investimeve ( me Vendim të Këshillit Teknik të AKUM Nr 47 datë 13.11.2020 ku akordon vlerën e plotë për këtë objekt ) me shkresën Nr 2960 Prot të datës 19.11.2020 të protokolluar në Bashkinë Kucovë në datën 20.11.2020 me Nr 4076 Prot. vërejmë se ky objekt parashikohet në Seksionin III Veprat inxhinierike, neni 36, neni 38 grupi IV Tarifor, dhe për rrjedhojë oferta juaj refuzohet për shkak si ofertë anomalisht të ulët në bazë të interpolimit të VKM-së nr 354 datë 11.05.2016 “ Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territor, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim ”. Vlera minimale e lejuar sipas VKM-së së mësipërme është 3 770 993 lekë pa tvsh .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur informojmë se operatori ekonomik ofertues “**Instituti i Konsulencës në Ndërtim**” ‘IKN’ shpk me Nr NIPT-i K71828007J me ofertë ekonomike : **3 770 993** ( tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh, **është identifikuar si oferta e suksesshme** .

**Ankesa për vlerësimin, JO .**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **BASHKISË KUÇOVË**, bashkë me gjithë dokumentacionin e paraqitur për pjesëmarrje në tender, origjinal ose kopje e njehsuar me origjinalin para Noterit Publik , siç parashikohet në dokumentat e tenderit.

Në zbatim të nenit 21, pika 3 paragrafi i parë, të VKM nr. 914 , datë 29.12.2014, jo me vonë se 60 dite nga publikimi i këtij njoftimi, Autoriteti Kontraktor, njofton Operatorin Ekonomik të shpallur fitues. Po në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar neni 21 paragrafi i dytë, Operatori Ekonomik, duhet ti përgjigjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor brënda 5 ( pesë ) ditëve nga data e marrjes së njoftimit .

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do te procedohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik ”, i ndryshuar .

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29 / 12 / 2020**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Kreshnik HAJDARI**